




Pranuar / Dorezuar Puniljeno / Prodato Received / Delivered	24 - 12 - 0	viti god year	
Organ / Rjesia Organ / Jedinica Org / Unit	Pr Pret Pr Pret Pr Pret No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kohema Quantity
SRPMSHCK	3309 / 2020		1/4



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.353/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Çlirim Zeka, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr.353/2020, të datës 12.11.2020, të parashtruar në formë elektronike nga ankuesi [REDACTED] kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “Kompensim Material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.353/2020 e datës 12.11.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED]
- II. Detyrohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, qe brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në pajtim me legjislacionin në fuqi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme që ankuesit ti bëjë kompensimin e pagës sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 28.01.2020, duke filluar nga data e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi [REDACTED] në pozitën e punës “Zyrtar i Lartë” në Departamentin për Menaxhimin e Reformën e Administratës Publike dhe Integritet Evropian, pranë Ministrisë së Punëve të

Brendshme, me datën 12.11.2020 përmes e- mailit, ka parashtruar ankesë në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 18.11.2020, ka përcjell kërkesën përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli me datën 26.11.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për vërtetimin e gjendjes faktike si dhe vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën A nr.353/2020, e datës 12.11.2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për Përgjigje në ankesë te datës 18.11.2020; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 28.01.2020; Kartela e Nëpunësit; Përgjigje në ankesë e datës 26.11.2020; Akt Emërimi i datës 03.02.2014; Përshkrimi i Detyrave të Punës i datës 04.12.2013; Vendim i datës 28.01.2020; Procedimi në sistemin e pagave Ministria e Administratës Publike i datës 28.01.2020; Lista e pagave nga data 01.03.2020 deri më datë 31.03.2020; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 04.02.2020;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shtjelluar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e [REDACTED] është e *pjesërisht e bazuar, sepse:*

Kolegji konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet për shqyrtimin e ankesës në kuptim të pranueshmerisë së saj, ashtu siç kërkohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se mos ekzekutimi i pagës sipas aktit të pajtushmerisë mes dy palëve, paraqet shkelje dhe dëmtim nga institucioni për ankuesin, duke kërkuar nga Këshilli që të pranoj ankesën e tij dhe të njihet e drejta e realizimit të pagës për ditët e punës sipas Ndryshim dhe Plotësim Aktit të Emërimit të datës 28.01.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 03.02.2014 është i sistemuar në pozitën "Zyrtar i Lartë" në Departamentin për Menaxhimin e Reformën e Administratës Publike dhe Integritime Evropiane me koeficient të pagës shtatë (7), ndërsa me datë 28.01.2020, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike me Vendimin nr. 08, bazuar në aprovimin e Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil Nr. 04/13 të datës 28.01.2020, ka aprovuar për ankuesin harmonizimin e koeficienti tetë (8) të pagës, konform përshkrimit të ri të detyrave të punës "Zyrtar për Koordinim dhe Monitorim të Reformës". Pas këtyre vendimeve aprovuese, është bërë edhe Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit nr.03/2020 datë 28.01.2020, duke përcaktuar koeficientin tetë (8) të pagës.

Ankuesit deri me datën e parashtrimit të ankesës në Këshill, nuk i është kompensuar koeficienti i pagës sipas Ndryshim dhe Plotësim Aktit të Emërimit nr.03/2020 datë 28.01.2020.

Kolegji vlerëson së çdo procedurë për harmonizim dhe klasifikim të vendeve të punës dhe koeficienteve të pagës është përgjegjësi e organeve të punësimit dhe si e tillë duhet të zhvillohet

në pajtim me legjislacionin e aplikueshme lidhur me pagat dhe klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Pas konstatimit se organi i punësimit i ka aprovuar ankuesit harmonizimi e koficientit të pagës nga shtatë (7) në tetë (8), Kolegji vlerëson se nëpunësi civil ka të drejtën ligjore për pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë si dhe të drejtë në pagën e garantuar, në përputhje me dispozitat e përgjithshme të punës siç përcaktohet me nenin 3 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë ku thuhet "**Neni 3 Mbrojtja e të drejtave për pagë 1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë**".

Bazuar në atë që u konstatua si me lartë, Ministria e Punëve të Brendshme përkatësisht Sekretari i Përgjithshëm është e obliguar që ankuesit t'i bëjë kompensimin e pagës në vlerën e koficientit tetë (8) sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 28.01.2020, nga data e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e pagës me koficient tetë (8) sipas Vendimit të datës 28.01.2020 të Sekretari të Përgjithshëm në mënyrë retroaktive duke filluar nga data 28.01.2020, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se pretendimi ankimor është i parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "*Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ*".

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga kryetarja e Kolegjit për shqyrtim dhe Vendosje të kësaj ankese.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A. Nr. 353/2020

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Ardita Haxhnikaj
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [REDACTED]
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së

